



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

RrGGK Kundër Projektligjit për Amnistinë

Prishtinë, 4 korrik 2013 – Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) reagon kundër Projektligjit për Amnistinë dhe u bën thirrje deputetëve të Kuvendit të Kosovës të mos votojnë këtë Projektligj sepse me këtë Projektligj po tentohet të amnistohen një numër marramendës i veprave kriminale. Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës duke u fshehur pas Marrëveshjes së Parë për Normalizimin e Marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, nënshkruar nga Kryeministrat Taçi dhe Daçiç, më anë të këtij ligji poashtu po falin një sërë të veprave kriminale duke e rrezikuar sundimin e ligjit në Kosovë.

Në këtë ligj amnistohen në mes tjerash edhe veprat kriminale të cilat shkelin të drejtat dhe liritë e njeriut si p.sh lëndimet e lehta trupore që në shumicën e rasteve të përndjekura ose të dënuara lidhen me rastet e dhunës në familje, uzurpimi i pronave si dhe një numër i veprave penale që janë kryer për përfitime individuale. Mënyra urgjente e procedimit për votim të këtij ligji nga ana e Qeverisë në Kuvendin e Kosovës, dekurajon qytetarët e Kosovës të jenë aktiv për të mirën e vendit të vet. Poashtu përmbajtja e këtij projektligji amnistion krimin dhe godet më së rëndi qytetarët e shumtë të Kosovës që për këto dekadat e fundit kanë punuar me mund dhe nder për ndërtimin e një Kosove funksionale dhe ligjore.

Prandaj RrGGK kërkon nga Kuvendi i Kosovës të mos e voton ligjin dhe ta kthen në rishqyrtim për të përpunuar një ligj me qëllime humanitare e jo kriminele.

PRESS

www.womensnetwork.org • Hajdar Dushi St. C-2 II/8, 10000
Prishtina, Kosovo • +381 (0) 38 245 850 •
info@womensnetwork.org